



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna Drenasit
Municipality Drenas
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 030/01-28803 dt. 15/07/ 2026

Në bazë të nenit 52 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 42, neni 44 pika 44.4 dhe pika 44.5 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 pika 12.2 dhe nenit 21 pika 21.2 të Rregullores së punës të Kuvendit të Drenasit, kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

Th ë r r e t

mbledhjen e **gjashtë** të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **datë: 22.07.2026** e cila do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e bordit të drejtorive, (kati tretë) i Komunës Drenasit.

Për mbledhje propozohet ky:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politike dhe Financa i datës: 18.06.2026.
2. Raporti i punës së Kryetarit dhe qeverisjes Lokale Janar-Qershor 2026.
3. Raporti Financiar Janar-Qershor 2026.
4. Të ndryshme

Drenas, 15.07.2026



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

[Signature]
Burim Bujupi



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-28805 dt. 15/07/ 2026

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 18.06.2026, e cila filloi në orën 10:10.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KPF-së: Burim Bujupi, kryesues i Kuvendit, Fitore Morina-Hoxha (PDKRLL), Selman Çallapeku (PDKRLL), Pajtime Berisha (PDK), Arigon Sinani (PDK), Egzona Tërdevci (VV) dhe Arbër Halilaj (BD).

Të pranishëm ishin edhe: Enver Hoxha, Drejtor i Financave, Nexhmedin Gruda, Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Alban Zogaj, Drejtor i Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Burim Bujupi**, kryesues i Kuvendit.

RENDI I DITËS:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politike dhe Financa i dt. 25.05.2026;
2. Propozim vendim për financimin e projektit OJQ "Klubi KFF Feronikeli" Femra;
3. Propozim vendim për financimin e projektit për OJQ "Klubi i Futsallit FC "Liqeni";
4. Propozim vendim për financimin e projektit për OJQ "Shotë Galica";
5. Propozim vendim për financimin e projektit për OJQ "Klubi i voleybollit Gryka";
6. Propozim vendim për financimin e projektit për OJQ KV "Feronikeli Femrat";

7. Propozim vendim për financimin e projektit OJQ KV“Feronikeli Meshkujt”;
8. Propozim vendim për financimin e projektit për OJQ “Klubi i Futsallit Drenasi”;
9. Propozim vendim për financimin e projektit për OJQ “Klubi i Futbollit FC Feronikeli 74”;
10. Propozim vendim për financimin e projektit për OJQ “Klubi i Futsallit Komorani”
11. Raporti i KRU “Prishtina”, Dega në Drenas;
12. Raporti nga Kryeshefi i KRM “Pastrimi”;
13. Draft Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2027-2029;
14. Propozim vendim për Shfuqizimin e vendimit 02 Nr.020/04-19807 të datës 29.05.2026 për themelimin e komisionit për verifikimin e lejeve ndërtimore nga viti 2017 e deri në vitin 2026;
15. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, pasi përshëndeti të pranishmit, hapi diskutimin për rendin e ditës.

Egzona Tërdevci theksoi se, lidhur me pikën 14 në shkresë nuk ka një kërkesë të prerë për shfuqizim dhe nuk thuhet që vendimi është në kundërshtim me ligjin. Ministria thjesht specifikon që nuk e ka të përcaktuar këtë procedurë, por ua lë në diskrecion komunës që të rregullojnë këtë çështje me ligjet e tjera në fuqi. Prandaj, propozoi se do të ishte më korrekte që kjo pikë të trajtohej si shqyrtim i ligjshmërisë apo diskutim mbi vendimin, sesa si shfuqizim.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi sqaroi se, përderisa Ministria konfirmon që komuna ka të drejtë të formojë një komision të tillë, nuk ka nevojë që ky vendim të dërgohet fare për ligjshmëri, ashtu siç veprohet edhe me komisionin rekomandues të formuar nga Zyra e Kryetarit.

Pas diskutimit, **kryesuesi Burim Bujupi**, hodhi në votim rendin e ditës. Për votuan 7 anëtarë, abstenime 0, kundër 0. Rendi i ditës miratohet dhe rekomandohet për Kuvend.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës.

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i datës 25.05.2026.

Meqenëse nuk pati diskutime, pika u hodh në votim. Për votuan 7 anëtarë, abstenime 0, kundër 0.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës.

2. Propozim-vendim për financimin e projektit të OJQ-së „Klubi KFF Feronikeli“ (Femrat).

Egzona Tërdevci, kërkoi që anëtarëve t'u vihen në dispozicion materialet e plota me të cilat kanë aplikuar klubet dhe organizatat. Ajo po ashtu theksoi nevojën për të pasur qasje në listën e aplikuesve të cilëve u janë refuzuar subvencionet, duke besuar që ekziston një raport i komisionit me listën dhe arsyet e refuzimit. Në rast se këto materiale nuk mund t'u dërgohen në këtë formë, do t'i kërkojë përmes kërkesës zyrtare për qasje në dokumente publike.

Drejtor i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Alban Zogaj, deklaroi se transparenca është 100% dhe se janë të gatshëm të ofrojnë cilindo dokument që anëtarët kanë dëshirë të shohin, përfshirë të dhënat se cilat OJQ janë përkrahur dhe cilat janë refuzuar.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, pasi nuk pati diskutime të tjera e hodhi në votim pikën e dytë të rendit të ditës. **Propozim-vendim për financimin e projektit të OJQ-së „Klubi KFF Feronikeli“ (Femrat).** Për votuan 7 anëtarë, kundër 0, abstenime 0.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi prezantoi pikat nga numër 3 (tre) deri në numër 10 (dhjetë) të rendit të ditës. Të gjitha këto pika u miratuan në mënyrë unanime për t'u rekomanduar për Kuvend, me përjashtim të pikës. **8 (tetë) „Propozim-vendim për financimin e projektit për OJQ-të 'Klubi i Futsallit Drenasi'“.** Lidhur me këtë pikë, kryesuesi deklaroi se abstenon për shkak të konfliktit të interesit. Megjithatë, pika 8 kaloi dhe u rekomandua për Kuvend. Për votuan 6 anëtarë, kundër 0, abstenime 1.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës. **11. Raporti i KRU „Prishtina“, Dega në Drenas.**

Egzona Tërdevci tha se, nuk është e drejtë të trajtohen njëjtë KRU „Prishtina“ dhe KRM „Pastrimi“, pasi të kompania „Pastrimi“ Komuna është aksionare, ndërsa KRU „Prishtina“ është një ndërmarrje qendrore që ka vetëm një degë në Drenas.

Së dyti, potencoi së trajtimi i këtij raporti në Komitet nuk ka kuptim, pasi kjo çështje tashmë është iniciuar për t'u trajtuar në një seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit. Lidhur me këtë të fundit, shprehu një kritikë për vonesën e thirrjes së seancës së jashtëzakonshme, duke kujtuar se afati ligjor për ftesë është tri ditë. Duke parë urgjencën që kanë deklaruar vetë iniciatorët, ftesa për seancë pas një jave është e paarsyeshme dhe e vonuar, do të ishte më mirë të mos thirrej fare. Duhet të bisedohet me thirrësit e seancës dhe kjo pikë ose të trajtohet në një seancë të rregullt, ose, nëse trajtohet në seancën e jashtëzakonshme, të mos rekomandohet fare nga Komiteti për në Kuvend, për të shmangur një punë të dyfishtë.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi njoftoi se, gjatë mbledhjes solemne të dt.12.06.2026, e kishte njoftuar thirrësin e seancës, Artian Krasniqin, se ky raport ishte paraparë si pikë e rendit të ditës në mbledhjen e Komitetit. Sipas kryesuesit, z. Krasniqi i kishte kërkuar që të mos ndërhynte të asamblastët. Kryesuesi garantoj para anëtarëve se nuk ka kontaktuar asnjë asamblist për këtë çështje, pasi është e drejtë e secilit prej tyre të kërkojë seancë të jashtëzakonshme në momentin që mblidhet një e treta e nënshkrimeve të nevojshme. Sa i përket afatit prej një jave për mbajtjen e seancës, kryesuesi sqaroi se kishte kontaktuar sërish thirrësin e seancës për t'i sugjeruar që në mbledhje të ftohej edhe udhëheqësi i KRU „Prishtina“, me qëllim që të raportonte dhe të sqaronte arsyet e mungesës së ujit. Pas pranimi të këtij propozimi, KRU „Prishtina“ u njoftua përmes email-it, por zyrtarët e saj deklaruan se nuk kishin mundësi të merrnin pjesë para ditës së hënë. Kjo ishte arsyeja pse u vendos që seanca e jashtëzakonshme të caktohej për dt. 22.06.2026. Kryesuesi u shpreh se prapëseprapë është i mendimit që thirrja për seancë të jashtëzakonshme të tërhiqet, meqenëse kjo çështje tashmë është përfshirë si pikë e rendit të ditës.

Pajtime Berisha tha se, duke vlerësuar se seanca e jashtëzakonshme duhet të mbahet domosdoshmërisht, pasi për këtë qëllim janë dhënë edhe nënshkrimet e asamblastëve. Shtoi se ndonëse dihet që zgjidhja e problemit të ujit të pijshëm nuk varet drejtpërdrejt nga Komuna e Drenasit, është e nevojshme që të merren hapa konkretë për ta tejkaluar këtë situatë të rëndë.

Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Nexhmedin Gruda tha se, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës theksoi se, së paku për arsye morale, menaxheri i degës në Drenas, z. Sokol, ose Kryeshefi i KRU „Prishtina“ nga Prishtina, do të duhej të vinin për t'u përballur me gjendjen dhe për të diskutuar në mbledhje.

Arbër Halilaj, i cili gjatë diskutimit për pikën 11 u shpreh se ky është një problem i madh dhe se zgjidhja e tij afatgjatë varet ekskluzivisht nga investimet e nivelit qendror. Megjithatë, duke qenë se bëhet fjalë për një problem emergjent, ai vlerësoi se në mbledhje duhet të ftohet Kryeshefi i KRU „Prishtina“ e jo vetëm drejtori i degës në Drenas. Tha se, kjo kompani inkason mjete në këtë rajon dhe po harrohet që fatura është një lloj kontrate, nëse njëra palë e shkel atë duke mos siguruar furnizim me ujë, atëherë është prishur marrëveshja me konsumatorin. Trajtimi i kësaj çështjeje në Komitet është shumë më i rëndësishëm sesa seanca e jashtëzakonshme, pasi sipas tij, mënyra se si është thirrur ajo seancë duket më shumë si marketing politik. Seanca e jashtëzakonshme nuk thirret me një nënshkrim të publikuar ku paraqiten gjashtë pika të rendit të ditës, të cilat realisht mund të përmbliidhen në një pikë të vetme. Është e domosdoshme që në seancë të ftohet kryeshefi për të paraqitur një plan emergjent dhe për të prezantuar para asamblesë masat që planifikojnë të ndërmarrin aktualisht. Tha se e përkrah këtë pikë të rendit të ditës, me kusht që të sigurohet pjesëmarrja e të dy përgjegjësve – si e atij të nivelit qendror, ashtu edhe e drejtorit të degës në Drenas.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi ndërhyri duke theksuar se, në cilësinë e kryesuesit, së bashku me Zyrën e Kuvendit dhe drejtorin përkatës, do të ushtrojnë presionin e duhur që, përveç raportit, kompania të ofrojë edhe informata shtesë rreth situatës së furnizimit me ujë në Drenas në vazhdimësi.

Pajtime Berisha, sheksoi se edhe drejtori e pohoi që po krijohen keqkuptime në terren, pasi banorët e komunës tonë po mendojnë që faji për mungesën e ujit të pijshëm qëndron të Komuna.

Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Nexhmedin Gruda sqaroi se, gjatë komunikimit me udhëheqësit e KRU „Prishtina“, ishin marrë vesh që ata të merrnin pjesë dhe të raportonin në seancën e rregullt të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, meqenëse kjo çështje është e paraparë si pikë e rendit të ditës edhe për seancën e Kuvendit, anëtarët e Komitetit ta njoftojnë thirrësin e seancës së jashtëzakonshme se nuk ka nevojë që këshilltarët komunalë të mbliidhen dy herë për të njëjtën temë. Zyrtarët e kompanisë nga Prishtina nuk do të vijnë dy herë për të njëjtën çështje, megjithatë mbetet në vullnetin e anëtarëve nëse dëshirojnë ta njoftojnë thirrësin.

Egzona Tërdevci, e cila i sugjeroi kryesuesit që t'i përcjellë thirrësit të seancës rekomandimin e përbashkët të Komitetit, që kjo pikë të diskutohet në seancën e rregullt. Tha se nuk ka as logjikë e as arsyeshmëri që e njëjta pikë të trajtohet në dy seanca të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi konstatoi se, të gjithë anëtarët e Komitetit pajtohen që të kontaktohet thirrësi i seancës së jashtëzakonshme, duke shprehur besimin se edhe ai do të jetë dakord që raportimi i KRU „Prishtina“ të bëhet drejtpërdrejt në seancën e rregullt të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës.
12. Raporti nga Kryeshefi i KRM „Pastrimi“.

Egzona Tërdevci, vuri në dukje mungesën e materialit, duke thënë se anëtarët nuk e kanë pranuar ende raportin e shkruar. Në rast se ky material nuk u dërgohet përpara seancës, pika do të mbetet vetëm në nivel informimi, pasi pa pasur dokumentacionin përpara, nuk mund të adresojnë apo të analizojnë asnjë çështje konkrete.

Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Nexhmedin Gruda sqaroi se, janë në kontakt të vazhdueshëm me KRM „Pastrimi“ dhe se ia kanë kërkuar raportin paraprakisht. Ai njoftoi se deri më sot raporti nuk ka arritur zyrtarisht në komunë, mirëpo menaxhmenti i kompanisë „Pastrimi“ ka konfirmuar se do të jetë i pranishëm në seancën e Kuvendit për të raportuar.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, kërkoi që ky raport të bëhet gati sa më parë, në mënyrë që të dërgohet si material i rregullt përmes email-it të këshilltarët komunalë, me qëllim që ata të jenë të përgatitur për mbledhjen e rregullt të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës.
13. Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2027–2029.

Egzona Tërdevci tha se, këtë çështje e ka adresuar disa herë dhe ngriti shqetësimin për mosdefinimin e saktë të kodeve të projekteve. Ajo mori si shembull rastet kur figurojnë projekte si „asfaltimi në tri fshatra“, por pa u specifikuar se cilat rrugë konkretisht do të asfaltohen. Ajo shtoi se për asamblastët është shumë e vështirë të votojnë buxhetin kur nuk e dinë saktë se ku do të investohen mjetet. Për këtë arsye propozoi me mirëkuptim që të ketë një ndarje më të rregullt dhe specifike të projekteve (p.sh. për fushat sportive, të dihet se ku dhe sa fusha do të ndërtohen), gjë që do t'u ndihmonte shumë asamblastëve gjatë vendimmarrjes.

Drejtori i Financave, Enver Hoxha dha një sqarim teknik, duke treguar se problemi qëndron të sistemi PIP (Programi i Investimeve Publike), i cili ka hapësirë të kufizuar dhe nuk lejon përshkrime më të gjata të projekteve. Ai po ashtu përmendi se propozimet dhe procedurat zgjasin rreth tre muaj dhe kjo shpesh po shkakton vonesa ose humbje të projekteve.

Egzona Tërdevci, tha se e kupton kufizimin teknik që ka sistemi PIP, mirëpo pyeti nëse është e mundur që asamblastëve t'u vihet në dispozicion një raport i veçantë plotësues, ku sqarohet saktë se për cilat rrugë bëhet fjalë. Tha se qëllimi nuk është të ngarkohet drejtorja, por është parësore të dihet destinimi i saktë i projekteve përpara se të votohen. Nëse kjo nuk arrihet të bëhet për këtë mbledhje, të paktën të jetë gati për muajin gusht, kur edhe miratohet buxheti përfundimtar.

Drejtori i Financave, Enver Hoxha, u zotua se do t'u bëjë kërkesë zyrtare të gjitha programeve dhe nënprogrameve që dorëzojnë kërkesa për investime kapitale, që të specifikojnë dhe të sqarojnë secilën rrugë apo projekt, duke shprehur besimin se edhe ata do ta mirëkuptojnë këtë nevojë për transparencë.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, duke potencuar se kjo çështje e kodimit të projekteve ka qenë temë diskutimi edhe gjatë punëtorisë së mbajtur, duke u pajtuar se është shumë mirë që për secilin investim kapital të dihet saktë se në cilën rrugë apo lagje do të realizohet.

Egzona Tërdevci, sqaroi se nuk kishte pasur mundësi të merrte pjesë në punëtori për shkak të angazhimeve të saj personale. Megjithatë, ajo ngriti si shqetësim faktin që ia kishte kërkuar draftin udhëheqësit të Zyrës së Kuvendit, e cili i kishte premtuar se do t'ia dërgonte, por ende nuk kishte pranuar asgjë. Nuk është korrekte që anëtarët që nuk mund të marrin pjesë në punëtori të mos trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të mos kenë qasje në materialet dhe diskutimet që janë zhvilluar atje.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, i dha të drejtë znj. Tërdevci dhe u zotua se do të angazhohet personalisht që t'i dërgohen të gjitha materialet dhe dokumentet e punës që janë trajtuar në atë punëtori. Pasi nuk pati diskutime të tjera, **kryesuesi**, e hodhi në votim pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës. **13. Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2027–2029. Për votuan 7, kundër 0, abstenime 0.**

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e katërmëdhjetë të rendit të ditës. **14. Propozim-vendim për Shfuqizimin e vendimit 02 Nr. 020/04-19807 të datës 29.05.2026 për themelimin e komisionit për verifikimin e lejeve ndërtimore nga viti 2017 e deri në vitin 2026.**

Arigon Sinani, theksoi se përderisa Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) nuk e ka kthyer vendimin si të jashtëligjshëm apo me kërkesë për shfuqizim dhe meqë Kuvendi tashmë e ka miratuar atë, propozimi i Kuvendit duhet të mbetet në fuqi. Ai shtoi se nuk ka nevojë që ky vendim të shfuqizohet dhe se situata aktuale është në rregull.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, sqaroi se Komuna mund ta formojë përsëri një komision për verifikimin e lejeve ndërtimore, por këtë herë pa pasur nevojë që vendimi të dërgohet në Ministri për vlerësim të ligjshmërisë. Ky vendim specifik, i cili tashmë është dërguar për ligjshmëri, duhet të shfuqizohet patjetër.

Arbër Halilaj, propozoi si alternativë që një komision i tillë të formohet drejtpërdrejt nga Kryetari i Komunës, duke përfshirë në të edhe përfaqësues nga Drejtoria e Inspeksionit.

kryesuesi Burim Bujupi, hodhi në votim pikën e katërmëdhjetë të rendit të ditës për t'u rekomanduar për Kuvend. **Propozim-vendim për Shfuqizimin e vendimit 02 Nr. 020/04-19807 të datës 29.05.2026 për themelimin e komisionit për verifikimin e lejeve ndërtimore nga viti 2017 e deri në vitin 2026.**
Për votuan 4, kundër 3, abstenime 1.

Arbër Halilaj, dha një sqarim rreth votimit, duke u shprehur se vota e tij mund të jetë keqkuptuar. Ai sqaroi se në seancë e ka votuar themelimin e këtij komisioni dhe vazhdon të jetë pro funksionalizimit të tij. Megjithatë, pas leximit të arsytimit, ai vuri në dukje se MAPL-ja, për çështje specifike, ka të drejtë t'i drejtohet një ministrie tjetër linje, siç ka vepruar në këtë rast me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Kjo e fundit ka konstatuar se

procedura për formimin e këtij komisioni nuk është e rregulluar në nivel qendror dhe se ky akt mbetet në kompetencë të organeve komunale. Prandaj, z. Halilaj përsëriti propozimin që një komision i tillë të formohet nga Kryetari i Komunës dhe që Ministria të ofrojë sugjerimet përkatëse se si duhet të veprohet më tutje.

Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e pesëmbëdhjetë (të fundit) të rendit të ditës. **15. Të ndryshme**

Egzona Tërdevci, e cila drejtoi një kërkesë te Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave në emër të banorëve të lagjes Morina, lidhur me rrugën „Flamur Morina“, për vendosjen e ndriçimit publik. Ajo potencoi se kjo kërkesë është adresuar zyrtarisht edhe gjatë dëgjimeve buxhetore nga administratori i fshatit, dhe kërkoi të dijë nëse ka ndonjë përgjigje konkrete apo nëse kjo çështje thjesht duhet të regjistrohet si problem për t'u adresuar në të ardhmen.

Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Nexhmedin Gruda, u përgjigj se kjo çështje është në kompetencë të Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale dhe se përgjigja zyrtare do të merret nga drejtori i asaj drejtorie.

Pajtime Berisha, paraqiti një propozim që të gjitha shkollat në komunën tonë, të cilat ende nuk e aplikojnë këtë praktikë, të pajisen me uniforma shkollore. Ky projekt do të realizohet me vetëfinancim nga prindërit. Tha se vendosja e uniformave standarde do të kontribuonte drejtpërdrejt në rritjen e barazisë sociale ndërmjet nxënësve, do të rriste disiplinën dhe do të mundësonte një identifikim më të lehtë e më të sigurt të nxënësve brenda dhe jashtë ambienteve shkollore.

Kryesuesi Burim Bujupi, deklaroi se pasi nuk pati diskutime pyetje apo sygjerime të tjera, e shaplli mbledhjen e mbyllur .

Mbledhja përfundoi në orën 11:20.

Procesmbajtësja: Fakete Hoti

Lekturoi: Nikelinda Bujupi

Kryesuesi i Kuvendit

Burim Bujupi





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Komuna/Opstina/Municipality Drenas (Glllogoc)
Zyra e Kryetarit



01 Nr. 400/01-28780 Dt. 15/07/2026

RAPORTI FINANCIAR JANAR - QERSHOR 2026

KORRIK 2026

1. Hyrje dhe baza Ligjore

Raporti financiar buxhetor, për periudhën Janar – Qershor 2026, është përgatitur në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafët: 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit, nr. 03/L – 048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Raporti i përgatitur nga Kryetari i Komunës mbulon periudhë Janar – Qershor të vitit fiskal 2026 dhe paraqet informatat që kanë të bëjnë me arkëtimin e të hyrave vetanake, shpenzimet dhe të dhënat mbi investimet kapitale.

1.1. Performanca e të hyrave

Gjatë periudhës **janar–qershor 2026**, të hyrat e përgjithshme janë realizuar në vlerë prej **1,138,900.43 €**, ndërsa në të njëjtën periudhë të vitit 2025 vlera e arkëtuar ishte prej: **1,340,451.09 €**. krahasuar me vitin paraprak, është evidentuar një **rënjë prej 201,550.66€** - përkatësisht **11,77 %**.

1.2. Performanca e shpenzimeve

Gjatë periudhës **janar–qershor 2026**, shpenzimet e përgjithshme të komunës janë realizuar në vlerë prej **11,869,529.14 €**, ndërsa në të njëjtën periudhë të vitit 2025 ato ishin **10,284,173.51 €**. Krahasuar me vitin paraprak, është shënuar një **rritje prej 15.42%**, respektivisht **1,585,355.63 €** më shumë. Në raport me buxhetin e planifikuar për vitin 2026 prej **23,734,533.00 €**, realizimi i përgjithshëm i shpenzimeve arrin në **50.01%**, që paraqet një nivel të kënaqshëm të realizimit për gjashtëmujorin e parë të vitit.

Shpenzimet operative

Shpenzimet operative janë realizuar në vlerë prej **8,956,893.74 €**, krahasuar me **7,129,106.41 €** në periudhën e njëjtë të vitit 2025. Kjo paraqet një **rritje prej 25.64%**, ndërsa realizimi ndaj buxhetit të planifikuar për vitin 2026 është **55.58%**. Rritja e kësaj kategorie tregon intensifikim të aktiviteteve operacionale dhe funksionim normal të institucioneve komunale gjatë gjashtëmujorit të parë.

Paga dhe shtesat

Në kategorinë **Paga dhe shtesa** janë shpenzuar **7,557,680.01 €**, ndërsa në vitin 2025 ishin realizuar **5,968,684.16 €**. Kjo paraqet një **rritje prej 26.62%**, ndërsa realizimi i buxhetit për këtë kategori ka arritur në **57.59%**. Rritja vjen edhe prej ekzekutimit të pages së 13-të e cila nuk ka qene e planifikuar për vitin 2026.

Mallrat dhe shërbimet

Shpenzimet për **Mallëra dhe shërbime** janë realizuar në vlerë prej **1,131,107.56 €**, krahasuar me **1,013,488.92 €** në vitin paraprak, duke shënuar një **rritje prej 11.61%**. Shkalla e realizimit të buxhetit për këtë kategori është **43.73%**, duke treguar se një pjesë e konsiderueshme e furnizimeve dhe kontratave të planifikuara pritet të realizohet gjatë gjashtëmujorit të dytë. Nga kjo kategori e shpenzimeve vlera prej **370,834.66 €** janë ekzekutuar për vendime gjyqësore (kontratat kolektive).

Shpenzimet komunale

Shpenzimet komunale janë realizuar në vlerë prej **268,106.17 €**, krahasuar me **146,933.33 €** në të njëjtën periudhë të vitit 2025. Kjo përfaqëson **rritjen më të lartë ndër të gjitha kategoritë**, prej **82.47%**, ndërsa realizimi ndaj buxhetit është **66.06%**. Nga kjo kategori e shpenzimeve vlera prej **23,297.54 € janë ekzekutuar për vendime gjyqësore (kontratat kolektive)**.

Subvencionet dhe transferet

Në kategorinë **Subvencione dhe transfere** janë realizuar **234,574.10 €**, ndërsa në vitin 2025 ishin realizuar **271,151.93 €**, duke shënuar një **ulje prej 13.49%**. Realizimi ndaj buxhetit vjetor është **31.55%**, çka tregon se pjesa më e madhe e subvencioneve dhe transfereve është planifikuar të ekzekutohet gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit.

Shpenzimet kapitale

Shpenzimet kapitale janë realizuar në vlerë prej **2,678,061.30 €**, krahasuar me **2,883,915.17 €** në vitin 2025, duke shënuar një **ulje prej 7.14%**. Realizimi ndaj buxhetit të planifikuar prej **6,875,138.00 €** është **38.95%**. Niveli më i ulët i realizimit në gjashtëmujorin e parë është karakteristik për projektet kapitale, pasi shumica e tyre zhvillohen dhe përfundojnë gjatë pjesës së dytë të vitit, pas përfundimit të procedurave të prokurimit dhe fillimit të punimeve. Nga kjo kategori e shpenzimeve vlera prej **300,647.07 € janë ekzekutuar për vendime gjyqësore (kontratat kolektive)**.

Analiza e realizimit të shpenzimeve për periudhën **janar–qershor 2026** tregon se komuna ka realizuar **50.01% të buxhetit vjetor**, duke ruajtur një dinamikë të mirë të ekzekutimit të buxhetit. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025, shpenzimet e përgjithshme janë rritur për **15.42%**, kryesisht si rezultat i ekzekutimit të pages se 13-të dhe vendimeve gjyqësore për kontrata kolektive.

Sa i përket **buxhetimit gjinor** mund të themi se përqindja e femrave në listën e të punësuarve arrin në **56.3 %** dhe buxheti i pagave i shpenzuar për këtë kategori ka shkuar në këtë përqindje të shpenzimit. Gjithashtu në periudhën Janar-Qershor komuna ka ndarë subvencione për lehona dhe sherim rreth **58,718.00 €**, 3 bursa **1,500 €** (bursiste femra). Pjesa tjetër e subvencioneve është shpenzuar për shërbime të varrimit **33,200.00 €** dhe transportit **74,532.70 €**.

Të hyrat vetanake për tremujorin e dytë të vitit 2026 dhe krahasimi me vitet paraprake

Përshkrimi	2024	2025	2026	Krahasuar 2026/ 2025(%)
	në Euro			
1. GJITHSEJ TË HYRA	926,385.40	1,340,451.09	1,138,900.43	84.96
Të hyrat direkte	716,073.69	786,794.09	618,311.43	78.59
Të hyrat Indirekte	210,311.71	553,657.00	520,589.00	94.03
1.1. Të hyrat nga kodi 16301	28,468.37	22,070.95	22,091.50	100.09
Taksa për certifikata (50013-50016)	23,745.00	18,396.00	18,430.00	100.18
Taksa per verifikimin e dokumenteve të ndryshme (50017)	1,848.87	661.46	359.50	54.35
Vert.Fotok.dokumentacionit (50018)	390.00	139.99	183.5	131.08
Kerkesat 50019	2,484.50	2,873.50	3,118.50	108.53
1.2.Të hyrat nga kodi 16601	8,524.60	18,235.50	12,552.00	68.83
Gjobat nga inspektorati 50104	8,524.60	18,235.50	12,552.00	68.83
1.3.Të hyrat nga kodi 17501	293,029.65	361,110.97	254,672.48	70.52
Tatimi në pronë 40110	227,162.65	287,485.97	173,736.48	60.43
Tax për regjistrimin e automjetit 50001	65,867.00	73,625.00	80,936.00	109.93
1.4. Të hyrat nga kodi 18001	1,009.50	1,007.00	1,243.50	123.49
Tax për parki.nga Sh.Publike 50008	1,009.50	1,007.00	1,243.50	123.49
1.5.Të hyrat nga kodi 18161	0	0	4,297.00	0.00
Tax për leje ndertimi 50009	0	0	4,297	0.00
Te hyrat nga kodi 47001	0	0	292.00	0.00
Taksa të tjera administrative 50019	0	0	292.00	0.00
1.6.Te hyrat na kodi 48001	45,225.70	42,310.00	15,520.00	36.68
Licenca per aktivitete individuale dhe profesionale te lira (50201)	45,225.70	42,310.00	15,520.00	36.68
1.7.Të hyrat nga kodi 65005	65,259.05	58,377.00	77,948.50	262.95
Taksa per nderrim te pronarit te tokes 50011-50012	33,754.50	25,280.00	13,599.00	53.79
Tax fletposeduese kopje planit. 50032	8,115.50	3,876.00	6,945.00	179.18

Qiraja nga pronat publike 50408	22,799.00	29,013.00	52,818.50	182.00
Matje gjeodezike 50504	590.00	208.00	4,586.00	4246.30
1.8.Të hyrat nga kodi 66310	230,291.32	232,742.08	180,496.50	77.56
Taks per leje ndertimi 50009	217,982.70	168,578.34	127,621.17	74.47
Taks per legalizim te objektev 50026	601.73	1,641.15	3,870.09	241.04
Shfrytzimi I pronës Publike 50405	11,645.89	6,085.84	34,537.19	567.59
Tax per ndrrim te tokës 50012	61.00	56,436.75	14,468.05	25.64
1.9.Të hyrat nga kodi 73100	21,958.00	23,855.69	18,185.41	76.23
Qiraja nga prona publike 50408	0.00	135.69	2,434.41	1794.10
Participimi shendetësi 50409	21,958.00	23,720.00	15,751.00	66.40
2.0. Te hyrat nga kodi 85001	86.50	142.00	261.00	183.80
Qiraja nga vendosja e objektev tregtare 50407	86.50	80.00	0.00	0.00
Qiraja nga prona publike 50408	0.00	62.00	261.00	420.97
2.1. Te hyrat nga kodi 92210	22,221.00	26,377.40	30,069.25	114.00
Participimi Arsimi	22,221.00	26,377.40	30,069.25	114.00
2.1. Te hyrat nga kodi 93000	0.00	565.50	682.29	120.65
Të hyra nga viti I kaluar 61000	0.00	565.50	682.29	120.65
2.1 Të Hyrat Indirekte	210,311.71	553,657.00	520,589.00	94.03
Gjobat e gjykatave	28,032.71	44,628.00	31,382.00	70.32
Gjobat e komunikacionit	182,279.00	509,029.00	489,207.00	96.11
1.7.3 Donacion	0.00	0.00	0.00	0.00

Shpenzimet për periudhën janar– qershor 2026 dhe krahasimi me vitet paraprake

Përshkrimi	2024	2025	2026	Buxheti për vitin 2026	% e shpenzimit
Vitet	1	2	3	4	Me vitin 2025
2. GJITHSEJ SHPENZIMI	9,222,996.65	10,284,173.51	11,869,529.14	23,734,533.00	115.42
Shpenzimet operative	7,300,793.89	7,129,106.41	8,956,893.74	16,115,895.00	125.64
2.1.1 Paga dhe mëditje	6,448,081.87	5,968,684.16	7,557,680.01	13,123,475.00	126.62
2.1.2. Mallra dhe shërbime	731,659.71	1,013,488.92	1,131,107.56	2,586,570.00	111.61
2.1.3 Shpenzime komunale	121,052.31	146,933.33	268,106.17	405,850.00	182.47
2.2 Subvencione dhe transfere	92,209.62	271,151.93	234,574.10	743,500.00	86.51
2.3 Shpenzime kapitale	1,829,993.14	2,883,915.17	2,678,061.30	6,875,138.00	92.86

Subvencionet për periudhën janar-qershor 2026 dhe krahasimi me vitet parapake

Përshkrimi	2024	2025	2026	% me
	Shumat në Euro			2025
Zyra e kryetarit	0.00	3,000.00	4,000.00	133.33
DSHPE	31,175.00	39,782.14	33,200.00	83.45
D.Bujqësisë	30,000.00	28,825.00	49,523.40	171.81
D.Zhvillimit ekonomik	5,757.62	-	-	-
D.Kulturës	4,777.00	128,350.00	13,100.00	10.21
Drejtorja e Shëndetësisë	17,000.00	70,694.79	58,718.00	83.06
Drejtorja e Arsimit	3,500.00	500.00	76,032.70	15,206.54
Gjithsej	92,209.62	271,151.93	234,574.10	86.51

Shpenzimet në projekte kapitale për periudhën janar-qershor 2026

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM-2/2026	Mbetja	Progresi i
					TM-2/2026 në %
1		2	3	4=2-3	5=3/2
16301	Administrata dhe personeli				
47919	Veture Zyrtare	100,000.00	8,140.00	91,860.00	8.14
	Totali	100,000.00	8,140.00	91,860.00	8.14

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM-2/2026	Mbetja	Progresi i
					TM-2/2026 në %
1		2	3	4=2-3	5=3/2
18001	DSHPE				
53330	Rreg.dhe rrethimi I varrezave Drenas dhe Komoran	20,000.00	-	20,000.00	-
53341	Zgjerimi i kamerave Drenas dhe Komoran	10,000.00	9,772.76	227.24	97.73
53364	Rregullimi dhe zgjerimi I vendndaljev dhe mbulimi I tyre	5,000.00	-	5,000.00	-
	Totali	35,000.00	9,772.76	25,227.24	27.92

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM-2/2026	Mbetja	Progresi i
					TM-2/2026 në %
1		2	3	4=2-3	5=3/2
18161	Drejtoria e Infrastruktures Publike				
48254	Rregullimi I shtratit të lumit Drenica dhe Verbica	35,000.00	11,000.00	24,000.00	31.43
48632	Asfaltimi I rrugës Gllanasellë, Godanc	20,000.00	20,000.00	0.00	100.00
48635	Asfaltimi I rrugës Paklek I vjeter, I Ri, Vasilevë	80,000.00	-	80,000.00	-
48638	Asfaltimi I rrugës Dobroshec, Çikatovë e vjeter	120,000.00	-	120,000.00	-
48643	Asfaltimi i rruges ne fshatrat Gradicë dhe Likoshan	50,000.00	50,000.00	0.00	100.00

48646	Asfaltimi rruges Arllat Negroc Gjergjic Bytyq	93,000.00	-	93,000.00	-
48648	Asfaltimi I rruges Sankoc Fushticë	50,000.00	-	50,000.00	-
48653	Asfaltimi I rruges Shtuticë, Verboc, Polluzhë	100,000.00	1,500.00	98,500.00	1.50
48656	Asfaltimi I rruges Llapushnik, Poterk Vukoc	50,000.00	-	50,000.00	-
48658	Asfaltimi I rruges Z. ulët, Lartë K. e ulet dhe e lartë	50,000.00	-	50,000.00	-
48661	Ndertimi I kapaciteteve të ujës-jellësit Drenas	600,000.00	487,970.32	112,029.68	81.33
48682	Bashkfinancim projektsh me donator te jashtem	25,000.00	-	25,000.00	-
49297	Zgjerimi dhe ndertimi I sheshit Fehmi e Xheve Lladrovci Dr.	751,802.79	536,737.26	215,065.53	71.39
49299	Asfaltimi I rruges Llapushnik Berish	2,000.00	-	2,000.00	-
51324	Asfaltimi I rrugve Tersteniku I, II dhe Gllobar	100,000.00	50,000.00	50,000.00	50.00
51340	Asfaltimi I rruges Baicë Krajkovë Damanek Shtrubullovë	50,000.00	-	50,000.00	-
52309	Ndërtimi I Rrugës Bregut te Çiqavicës	2,000.00	-	2,000.00	-
52310	Ndërtimi I parkut dhe shtigjet për Këmbësor	50,402.00		50,402.00	-
53631	Ndërtimi I Kolektorve për grumbullimin e ujërave te zeza	120,446.00	-	120,446.00	-
53635	Rregullimi I Trotuarve dhe ndriqimit Publik	720,000.00	335,000.00	385,000.00	46.53
53645	Asfaltimi I rrugëve dhe Kubzimi Drenas I, II, III, IV	320,000.00	63,989.18	256,010.82	20.00
53652	Asfaltimi I rrugëve Komorani I, II, III, IV	20,000.00		20,000.00	-
53659	Ndërtimi I Tombinave dhe mureve mbrojtëse	50,000.00	13,970.09	36,029.91	27.94
53660	Ndërtimi zgjerimi dhe rikonstruimi I rrugëve të asfaltuara	415,000.00	115,000.00	300,000.00	27.71

53666	Ndertimi, zgjerimi i rrjetit të kanalizimit	250,000.00	149,999.99	100,000.01	60.00
53670	Asfaltimi I rrugëve Abri dhe Tërdec	20,000.00		20,000.00	-
53672	Asfaltimi i rrugëve Nekoc Kizhnarekë	50,000.00	-	50,000.00	-
53674	Hapja e kanaleve Kulluese gjatë rrugëve Drenas Komoran	50,000.00	-	50,000.00	-
54100	Ndertimi I rrugëve fushore ne Komunën e Drenasit	269,965.00	261,689.63	8,275.37	96.93
54104	Ndertimi I rruges tranzit Drenas-Kroi I Mbretit	5,000.00	-	5,000.00	-
54108	Ndertimi I digës për ujëmbledhës në fshatin Verboc	2,000.00	-	2,000.00	-
54266	Rregullimi I inf.ne parkun e pishave ne Komoran- Fushticë	80,000.00	-	80,000.00	-
55568	Rehabilitimi I rruges dhe ndertimi I trotuarit Arllat-Negrovc dhe Vuçak	2,000.00	-	2,000.00	-
40	Ekzekutimi I Vendimeve Gjyqesore	301,605.00	300,347.07	1,257.93	
Totali		4,905,220.79	2,397,203.54	2,508,017.25	48.87

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM-2/2026	Mbetja	Progresi i
					TM-2/2026 në %
	1	2	3	5=2-3	6=3/2
47001	Bujqësia				
	Grant I donatorve te brendshem	2,213.32	-	2,213.32	-
Totali		2,213.32	-	2,213.32	-

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM-2/2026	Mbetja	Progresi i TM-2/2026 në %
------------------	------------	---------	----------------------	--------	---------------------------

	1	2	3	4=2-3	5=3/2
73100	Sherbimet e shendetesis primare				
49181	Paisje speciale mjeksore mbi 1000	10,000.00	2,945.00	7,055.00	-
55574	Ndertimi I QMF-se Arllat	100,000.00	-	100,000.00	-
55575	Rregullimi I oborreve dhe rrethojave te QKMF.QMF dhe AMF Arllat Sankoc Abri,Dobroshec dhe Vasileve	10,000.00	-	10,000.00	
	Totali	120,000.00	2,945.00	117,055.00	-

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM-2/2026	Mbetja	Progresi i TM-2/2026 në %
1	2	3	4=2-3	5=3/2	
75502	Sherbimet Rezidenciale				
54131	Ndertimi I shtepise per komunitete - sherbime komuale per persona me aftesi te kufizuara	230,000.00	-	230,000.00	-
	Totali	230,000.00	-	230,000.00	-

Kodi i projektit	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet TM-2/2026	Mbetja	Progresi i TM-2/2026 në %
1	2	3	4=2-3	5=3/2	
85001	Drejtoria e Kulturës 85001				-
89114	Ndertimi I stadionit faza e dyte	340,000.00	160,000.00	180,000.00	47.06
20712	Ndërtimi I fushave sportive Komoran,Korroticë e Eperme dhe Arllat	122,000.00		122,000.00	-
	Totali	462,000.00	160,000.00	302,000.00	34.63

Përshkrimi	Buxheti	Mbetja	Progresi i
------------	---------	--------	------------

Kodi i projektit			Shpenzimet TM-2/2026		TM- 2/2026 në %
	1	2	3	4=2-3	5=3/2
93000	Arsimi Fillor				
51325	Dixhitalizimi I institucioneve arsimore ne Drenas	100,000.00	-	100,000.00	-
54209	Instalimi I nxemjeve qendrore-riparimi I kulmit ne SHFMU"Xheladin Gashi -plaku" Komoran	110,918.00	-	110,918.00	-
54212	Ndertimi I SHFMU "Rasim Kiqina" Drenas paralele e ndare ne Shtrubullojë	300,000.00	-	300,000.00	
55604	Ndertimi I aneksit te shkolles "Arif Shala" dhe "Naim Frasheri"	175,000.00	100,000.00	75,000.00	
20703	Ndertimi I parkingjev ne shkolla "G.Elshani, A.Shala, A.Bejta, Xh.Gashi, B.Curri, D.Drenices, L.Gurakuqi, Rilindja, A.Bujupi, 24 Korriku	40,000.00	-	40,000.00	
20704	Ndertimi I rrethojave te fushave te jashtme sportive ne Sh.Galica, A.Bejta, G.Sylaj dhe D.Fortes	35,000.00	-	35,000.00	
20705	Ndertimi I rrethojave te oborreve te shkollave H.Prishtina, F.Grajqevci. dhe M.Gradica	40,000.00	-	40,000.00	
20707	Ndertimi I pjerrinave ne hyrje te objekteve shkollore per PAK,Shtuticë,Dobroshec,Gllanasell dhe Gllabar	10,000.00	-	10,000.00	
20708	Trafo per furnizim te objektit te qerdhes " Ardhmeria"	32,000.00	-	32,000.00	
20709	Instalimi I nxemjeve qendrore me pelet ne Gj.Kastrioti Skenderbeu, R.Kiqina, A.Gashi, Z.Hajdini, F.Lladrovci	50,000.00	-	50,000.00	
20710	Furnizimi I Shkollave me tabela te menqura dhe paisje percjellese	110,000.00	0	110,000.00	0

20711	Ndertimi I shkalleve emergjente ne shkollat fillore ne Komunen e Drenasit, B.Curri,R.Kiqina, Z.Hajdini , Migjeni, Gj.K.Skenderbeu, a.Bujupi, H.Bajraktari	20,000.00	-	20,000.00	-
	Totali	1,022,918.00	100,000.00	922,918.00	-

611	Totali KOMUNA	6,875,138.79	2,678,061.30	4,197,077.49	38.95
-----	----------------------	---------------------	---------------------	---------------------	--------------

Kryetari i Komunës



Ramiz Lladrovci

[Handwritten signature]